

Brajan Sukaj
Fytyra tjetër e Dionisit
Roman

BOTIMET TOENA

BRAJAN SUKAJ

FYTYRA TJETËR E DIONISIT

Roman

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817655

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjolllesha" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al/>

I

Duke qenë se nuk po gjej një mënyrë të goditur për të nisur këtë rrëfim, po dal direkt në temë: ka tri ditë që më kanë mbyllur në çmendinë dhe akoma nuk më kanë thënë përse.

Sigurisht, arsyeja është një privilegj që duhet fituar në një vend si ky ku ndodhem Unë. Nëse prisni që të filloj të flas për traumat e të kaluarës, frustrimet apo marrëzira të tilla, gaboheni. Këto nuk janë gjë tjetër veçse hijet që mjekët e pavijonit, të fshehur në muret e tyre, shfaqin në këtë shpellë platonike ku më kanë futur.

Jo vetëm që janë patetike, por edhe të panevojshme, duke qenë se prania Ime këtu është e kotë.

Shumë vite më parë, në bankat e shkollës, kur mësuesja po shpjegonte leksionin e Revolucionit Francez, befas mendja m'u hap dhe kuptova që shkolla ishte një nga institucionet më të rëndësishme të kontrollit. Ende më kujtohet patosi i saj kur tregonte për Dantonin dhe jakobinët ndërkohë që një zë brenda Meje më grafulloi si magma brenda një vullkani.

- Thuaje atë që po mendon, tani!

Dhe atëherë Unë ngrita dorën dhe e thashë para tridhjetë e gjashtë vetave. Dikush qeshi, por mësuesja bëri sikur nuk dëgjoi dhe vazhdoi me të vetën.

Përmenda këtë parentezën e shkollës, sepse ishte hera e parë në jetë që ndihesha i kontrolluar. Institucioni tjetër i kontrollit, çmendina, ishte një yjësi tjetër për mua, aq e largët, sa edhe më shpejtësinë e imagjinatës, do më duheshin pesëmbëdhjetë vite të tjera që të mbërrija.

Që Unë jam një i zgjedhur i Zotit për të realizuar planet e Tij në tokë, kjo as që vihet në diskutim. Në fillim pata vështirësi t'i ndaja ato zëra që më vinin nga hiçi, por pastaj arsyetova. Duke qenë se ishin kontradiktore, nuk mund të ishin fjalët e Tij. Shto edhe faktin që Ai ka folur në gjuhën e njerëzve vetëm nëpërmjet zbulesave hyjnore, u binda gjithnjë e më shumë që Ai nuk më fliste me fjalë, por me simbole. Por këto simbole duheshin interpretuar dhe këtu hynte në lojë intuita Ime. Të kuptohemi, shenjat janë ato që i paraprijnë ngjarjeve të rëndësishme në jetë, ndryshe nga besëtytnitë e kota dhe të pavlera.

II

Ishin ditët e fundit të punës tek institucioni shtetëror ku punoja. Këtë nuk ma tha njëri, por e kuptova. Nuk po më kërkonin më llogari, nuk më jepnin më punë, nuk më ngarkonin me përgjegjësi... Një mur i tillë apatie më përgatiti për atë që më priste.

Isha duke luajtur shah në kompjuter në zyrë, kur ra zilja e telefonit. Ishte një zile këmbëngulëse, nga ato që të shpojnë kafkën tejprtej si një heshtë e padukshme. Më shtyu madje të bëja një lëvizje gabim. Ngrita receptorin dhe u përgjigja i bezdisur. Nga ana tjetër dëgjova zërin formal të drejtoreshës së burimeve njerëzore. Më kërkoi që të paraqitesha tek zyra e saj. Iu përgjigja edhe Unë me të njëjtën ftohtësi, në mënyrë që të parodizoja formalitetin e saj, por nuk di nëse e kuptoi këtë gjë.

Vazhdova lojën derisa e humba, më pas u ngrita përtueshëm dhe u drejtova tek zyra e saj. Pllakat e korridorit ishin bardhë e zi si fusha e shahut. Duke qenë se unë e kisha humbur lojën, u binda akoma më shumë, se ku po më shpinin shenjat.

Hyra pa trokitur dhe qëndrova në këmbë, derisa më bëri me shenjë të ulesha. Ulur, m'u qartësua pamja e fytyrës së saj, e rrumbullt dhe me një palë sy të vegjël nën dy vetulla asimetrike.

Që të them të drejtën, jam shumë kërkues kur bëhet fjala për çështjen e bukurisë femërore. Tiparet duhet të jenë të gjitha në raport me njëri-tjetrin, dhe simetrikë, kuptohet. Sikur qoftë edhe një të dalë jashtë linje, aq mjafton që një femër të mos më pëlqejë. Shumica e femrave bëjnë pjesë tek ky grup. Grupi i dytë, një minorancë, është ai që më pëlqen me shikim të parë.

E kisha takuar disa herë drejtoreshën, por këtë herë, si kurrë më parë, po e studioja. Po i shihja me vëmendje detajet e fytyrës, më pas ngjyrën e rrobave dhe pastaj kalova tek thonjtë.

Ajo picërroi sytë, të cilët u dukën akoma më të vegjël në fytyrë. Më pas kryqëzoi gishtërinjtë dhe më komunikoi në mënyrën më të thukët të mundshme se marrëdhënia Ime e punës do të ndërpritej menjëherë. Më tej hapi një dosje, që duhej të ishte Imja dhe nisi të shfletonte.

Atëherë, Unë i kërkova arsyen, e ajo, pa shkëputur shikimin nga letrat, më tha që Administrata e Institucionit do t'i nënshtrohej një riorganizimi, dhe vendi im, do "suprimohej".

- Çfarë do të thotë "suprimim"? - pyeta unë.
- Nuk do të ekzistojë më si vend, - saktësoi ajo.

Sytë iu zvogëljuan akoma më shumë, aq sa u dukën si dy pika.

Atëherë i sqarova se sipas ligjit Unë duhej të kaloja në listë pritjeje derisa të lirohej një vend tjetër në Administratë.

- Është e drejta Jote, - tha ajo duke shkruar tek letrat në dosje. - Ndonjë gjë tjetër?

U ngrita dhe i ktheva shpinën.

- E fundit, se harrova.

- Çfarë?

- Më dorëzo çelësin e zyrës.

Nuk është se u mërzita tërësisht që nuk bëja më pjesë në Administratën e Institucionit. Kisha disa muaj që isha zgjuar nga një gjumë letargjik, dhe kuptova që isha prerë për gjëra të mëdha. Shumë të mëdha, dhe qëndrimi Im aty, ishte një lloj pengese.

Kur po kthehesha në zyrë, gjatë gjithë korridorit, po sillja në mendje se çfarë po mendonte në të vërtetë drejtoresha teksa fliste me Mua. Jam i bindur se gjuha formale nuk është diçka e sinqertë, prandaj është edhe aq e mërzitshme. Mendoni pak çfarë ferri do të ishte të jetoje me dikë që flet vetëm me zhargone. Në anën tjetër, ata të sinqertit, më pëlqejnë vetëm për arsyen se më bëjnë të qeshin. Nëse njeriu sillet në natyrshmërinë e tij, është e pamundur të mos të bëjë të qeshë. Njeriu në thelb është një qenie qesharake, dhe Institucionet e kontrollit, mundohen ta kthejnë atë, nën petkun

e vetëpërmbytjes, që na e servirin si virtyt, në një lloj qenieje tjetër.

Gjithsesi, mendja është një greminë mjaft e thellë. Nëse gjejmë guximin të futemi mjaftueshëm thellë, nuk është çudi që të dalim në kufijtë e një mendjeje tjetër. Është si një lloj rrjeti i stërmadh që lidh të gjithë njerëzit, përndryshe diçka që disa quajnë “Ndërgjegjja kolektive” nuk do të ekzistonte ndryshe.

Por nuk do të rrezikojë të futesha aq thellë në mendjen Time, sepse rreziku ishte tepër i madh që të ngatërroja rrugën, dhe në vend të mendjes së drejtoreshës, të përfundoja në atë të një përbindëshi.

III

Atë ditë shkova më herët në shtëpi. Sapo hapa derën, menjëherë përballesh me një fotografi Timen me nënën. Jam përpjekur disa herë që ta heq prej aty, por neglizhenca më bënte ta shtyja për një ditë tjetër. Dhe ajo foto kishte tre vjet në po atë vend. Pak a shumë sa kishte nëna që kish vdekur.

Ajo pat punuar në një fabrikë lyerje pantallonash xhins. Stofi vinte i bardhë dhe procesi i punës kërkonte që ta lyente me sprai blu. Vazhdoi vite ashtu, duke punuar pa maskë. Një ditë para se të lahej vuri re një gjëndër në gjoks. Kur u vizitua, mjeku i tha që të fillonte kimioterapinë menjëherë. Gjëja e parë që ajo tha ishte:

- Do të më bien flokët?

Mjeku e pa me sy të kapsallitur.

Rrugës për në shtëpi më tha thatë që nuk kishte ndërmend të ndërmernte asnjë kurë. Nuk u mundova t'ia mbushja mendjen. Ajo i kishte larë hesapet me këtë botë. Fundja është e drejta e gjithsecilit të vdesë në mënyrën që ai do. Vdekja është gjithandej, në çdo kafshatë që hamë, në çdo frymëmarrje që marrim e çdo

gotë me ujë që pimë. Çdo gjë është helm vdekjeprurës, vetëm se ndryshon sasia që na pret biletën për andej. Dhe natyrshëm mendoj që nuk ka ndonjë ndryshim si të vdesësh pesëmbëdhjetë apo tetëdhjetë vjeç.

Nuk kisha si ta prisja vdekjen e nënës në një mënyrë tjetër, përveçse me indiferencë. Ky mund të duket një skenar i parë në vende të tjera, por e vërteta ishte kjo.

Babai me gruan e tij u shfaqën ditën e vdekjes. Ishim ne të tre, dy miq, dhe arkivoli në mes të dhomës, me trupin e pajetë të nënës.

Rrinim pa folur duke tymosur, derisa babai, duke parë arkivolin, befas më tha që njihte një mikun e tij që kishte një agjenci funerale.

- Si biznes, duhet të jetë goxha fitimprurës, - i thashë, duke fikur cigaren në hirnore.

- Puna është e garantuar, - tha ai.

- Gjithsesi, - i thashë, - ndihem mirë në shtet.

- Sa fiton? - më pyeti.

- Gjashtëqind e pesëdhjetë, - i thashë. - Do një cigare tjetër?

Ai e mori, e thithi me afsh dhe nxori një re rrethore gati të përkryer.

- Si menaxher, - vazhdoi ai, - do të fitoje njëqind e pesëdhjetë më shumë, minimumi, tha ai duke tundur cigaren.

- Sa ngarkesë ka? - e pyeta.

- Mmm, - bëri ai, - ka ca.

- Atëherë preferoj punën në shtet, - i thashë.

Teksa po shihja fotografinë Time me nënën, m'u kujtua ajo bisedë. U hodha në kolltuk, mora celularin dhe i telefonova babait.

Kur e hapi, i thashë menjëherë që më pushuan nga puna.

Nga ana tjetër nuk dëgjova asnjë pipëtimë.

- E kam menduar atë punën, - i thashë.
- Çfarë pune? - tha ai pas një heshtjeje të gjatë.
- Tek agjencia funerale, nuk mban mend?
- Ma kujto sepse nuk e mbaj mend.
- Te funerali i nënës.
- Kanë kaluar... nuk e mbaj mend sa vjet.
- Po, dhe tani dua të punoj aty.

Babai më tha që do të pyeste dhe do të më jepte përgjigje.

Pashë orën dhe vërejta që duheshin edhe dy orë e gjysmë që orari zyrtar të mbaronte. Ndjehem goxha i papërgatitur kur rrjedha ditore e ngjarjeve prishet. Jo rrallë më ka dalë vetja jashtë kontrollit kur diçka del nga skema. Si rregull kam një standard bazë në gjërat që them dhe bëj, e, si pasojë, dhe përgjigjet e jashtme i kam të parashikuara. Nëse linja prishet, rrezikoj të them gjëra që ata të tjerët i konsiderojnë të pakuptimta. Prandaj kam prirje t'i largohem debateve si kolerës, rrezikojnë të marrin drejtime që një Zot e di se ku mund të shpjerin. Mund të më akuzoni që jam një frikacak që zgjedh gjithnjë rrugën e sigurt, por mua nuk më intereson fare kjo gjë.

Mbaj mend një herë, vite më parë, dëgjova për një konflikt midis dy vetave. Hyri një i tretë që t'i ndante dhe ishte i vetmi që përfundoi i plagosur. Askush fliste me vlerësim për atë. Të gjithë flisnin me mëshirë.

Ndërkaq, teksa po prisja përgjigjen e babait, pashë pluhurin që kishte turbulluar pamjen e xhamit të tavolinës së mesit. U ngrita dhe vëreja që ishte aq i trashë sa nuk pasqyronte më asgjë. Pashë rreth e rrotull dhe u ndërgjegjësova që po, shtëpia kishte nevojë për një pastrim.

Hapa dollapin dhe një re gri m'u shfaq përpara. U kollita dhe bëra me dorë që ta shpërndaja.

Ishin disa dokumente të vjetra. Dëftesa shkollore, vërtetime, dëshmi, etj.

I mora dhe bëra që t'i hidhja, por njëra ra në tokë. U ngrita që ta marr. Letra ishte zverdhur dhe germat ishin të shtypura me makinë shkrimi. Pashë që ishte një dorëshkrim pa titull. Nuk e mora vesh se çfarë donte ajo gjë midis atyre shkresave. Fillova të mendoja se kush mund të ketë qenë ai që e kish vendosur atë dorëshkrim aty. Jo për gjë, por ishte krejt pa lidhje me letrat dhe shkresat e tjera që ndodheshin aty. Për më tepër, kush dreqin shkruan ende me makinë shkrimi?

U krodha pas në kujtesë, për të gjetur se kush mund të kishte hyrë në shtëpinë Time, por asgjë. Hodha shkresat e tjera në kosh, ndërsa dorëshkrimin e mbajta me vete. Ai ishte i huaj dhe, sigurisht, po e shihja me dyshim. Dyshim që po më forcohej nga vetë fakti që

gjetja e këtij shkrimi të panjohur, ekzistencën e të cilit nuk e kam ndjerë kurrë në shtëpinë Time, përkonte me ditën që më larguan nga puna.

Ç' ishte e vërteta, kisha frikë ta lexoja.

Zilja e celularit më hodhi përprjetë.

Ishte babai. Më tha që pyeti tek agjencia funerale dhe mori përgjigje që kishte vetëm një vend të lirë, si shofer. I thashë që do ta mendoja dhe e mbylla.

U ktheva tek dorëshkrimi dhe nisa ta lexoja. Fliste për disa kujtime nga lufta e Kosovës. Kalova pesë faqe, por nuk më pëlqeu. Ishte i tejngarkuar me idealizma dhe kosovarët paraqiteshin si engjëj ndërsa shkiat si djaj. Nuk kam lexuar shumë, por më bën për të vjellë kur dikush cilëson si diçka apo dikë si absolutisht të mirë ndërsa diçka tjetër si burimi i gjithë të këqijave. Ku ka konflikt, ka faje të ndërsjella. Ajo që kisha në dorë nuk shpëtonte në asnjë pikë, faqe apo paragraf.

Por kjo nuk e largoi aspak frikën se kush mund të kish qenë ai që kish futur atë shkrim aty. E kuptoj që po bëhem i bezdisshëm duke i përsëritur gjërat, por ora e ardhshme pas leximit të atyre faqeve, kaloi duke vrarë mendjen për këtë.

Duke qenë se nuk arrita t'i jepja një përgjigje bindëse vetes, vendosa të zbrisja poshtë. Në katin e parë të apartamentit është një bankë e mirënjohur e nivelit të dytë. E dija faktin që kamerat e saj, kapnin edhe hyrjen e pallatit ku banoj Unë.

Shkova te njëra nga nëpunëset, dhe i thashë që dëshiroja të takoja mbikëqyrësin e kamerave.

- Përse? - pyeti ajo.

I sqarova që ishte një çështje personale dhe kisha nevojë ta takoja menjëherë.

Ma ktheu që kjo gjë ishte e pamundur dhe shtoi se diçka të tillë mund ta kërkonte policia kur kishte dyshime serioze për një krim.

- Atëherë nuk do të më ndihmoni, - i thashë i acaruar.

- Kam frikë se jo, - tha ajo duke rrudhur buzët.

- Shkofsh në drejt, - mërmërita i bezdisur dhe u largova.

IV

Mora përsëri babanë në telefon dhe i thashë që doja ta takoja sa më parë të ishte e mundur. Ai më la takim pas një ore tek një lokal në qendër të qytetit. Nuk po më zinte vendi. Zakonisht kur më lenë të presin, dal dhe ec pa ndonjë pikëmbërritje nëpër qytet. Kam bindjen se lëvizja sikur i përshpejton ato akrepa të mallkuara. Kokën e kisha të ngarkuar me mendime. E përfytyroja veten si dukesh. M'u kujtua shprehja e një nëpunësi tek Institucioni ku punoja. Ai thoshte se në sistemet diktatoriale, njerëzit jo vetëm që nuk mund të shpreheshin, por nuk lejoheshin as të mendonin.

- E si mund të kuptosh dikë që mendon? - i thashë duke qeshur.

- Kuptohet nga mimika që merr fytyra. Ajo nuk gënjen kurrë.

Në ato çaste po i jepja të drejtë. Ndjeja sikur fytyra më ishte pushtuar nga një ngërç i madh dhe, si pasojë, ishte ngrirë në një pozicion të caktuar.

Babai u tregua i përpiktë. Para se të niste bisedën, nxori një cigare. Pasi e thithi, tymin e nxjerrë nga

goja, e futi direkt në hundë. Ishte një stil që ma bënte shpesh kur pinim cigare bashkë, në kohën kur isha në gjimnaz. Në atë periudhë madje më mësoi që, nëse doja të nxirrja re rrethore, duhej ta bëja gojën si peshk dhe ta hapja e ta mbyllja me shpejtësi.

- Përse doje të më takoje, - tha ai, - për atë punën?

- Ajo është një çështje e dorës së dytë, - ia ktheva, krahasuar me atë që më ndodhi kur mbërrita në shtëpi. Pak pasi të flisnim bashkë herën e parë.

Ai më fiksoi në sy, duke pritur që të vazhdoja.

- Dikush më ka futur një dorëshkrim të çuditshëm në banesë, - i thashë.

- Nuk po kuptoj.

- Ishte një dorëshkrim i vjetër, i shkruar me makinë shkrimi. Dhe letrat ishin të zverdhura nga koha, kupton?

- Çfarë dorëshkrimi, dreqin.

- Fliste për luftën e Kosovës. Ishte shkruar keq, por nuk ashtë aty çështja. Çështja është se si ka përfunduar tek shtëpia Imë.

- Pse duhet të ketë rëndësi?

- Ka rëndësi sepse gjetja e tij, përkoj me ditën e pushimit Tim nga puna. Nuk është rastësi. Tani të lutem, më thuaj kush mund ta ketë vendosur aty.

Pas atyre fjalëve, e afrova fytyrën drejt tij për ta parë më mirë. Kishte filluar të djersinte pak, dhe, kryesorja, bebëzat e syve thuajse ishin zhdukur. Këtu kuptova që po më fshihte diçka. Gjëja e parë që

vërejnë makinat e të vërtetës është tkurrja e bebëzave. Tek ai, ishte aq e dukshme, sa nuk kishte nevojë për asnjë makineri. Shto pastaj frymëmarrjen që kish një gjashtëdhjetë sekonda që e kish ndërprerë.

- Kështu pra... - vazhdova, - që të jem më i qartë. Ka një arsye se përse gjërat janë ashtu siç janë...

- Dorëshkrime, gjëra që janë ashtu siç janë... nuk po kuptoj asgjë, - tha ai.

- Njëh ndokënd nga fisi ynë që ka shkuar në luftën e Kosovës?

- Jo. Por nëse të shqetëson kaq shumë, përse nuk e djeg? Pi një birrë pastaj, një sy gjumë, dhe të nesërmen do të ftillohesh.

- Kam një ide më të mirë.

- Çfarë? - tha babai duke ndezur cigaren e radhës me atë të konsumuarën.

- Do t'i bëj disa ndryshime, - thashë, - ashtu si i mendoj Unë gjërat.

- Shumë mirë, - ma ktheu ai, - bëj atë që do.

- Pastaj do e botoj.

- Nuk po e kuptoj këtë... Do ta botosh?

- Po!

- Përse?

- Duke e botuar, herët a vonë do ta nxjerrë kokën ai që ma ka futur në shtëpi atë dorëshkrim. Është pak a shumë si një dhëlpër që është futur në strofull. Unë i ndez zjarrin tek hyrja dhe pres. Herët a vonë do të dalë, sepse do të asfiksohet.

- Në rregull, tani kalojmë te puna.

- Mos ndërro bisedë, - thashë Unë. - Po flisnim për atë dorëshkrimin.

Ai u ngrit duke kontrolluar xhepat. Nxori disa kartëmonedha dhe një kartëvizitë.

- Unë po iki, - i dha fund bisedës. - Ky është numri i agjencisë funerale. Bëji një zile.

Bëra shenjë që të priste, në mënyrë që të dëgjonte më tej arsyetimin Tim, por ai u largua.

Tëmthat më rrihnin me forcë dhe kisha një pështjellim, pasi pas dy orësh do fillonte të perëndonte dielli. Parashikoja një natë pa gjumë. Në fakt, kur fillonte të errësohej, nga perëndimi e këtij me pak fjalë, mendimet negative për jetën bëheshin më të forta. Nuk është për t'u çuditur, pasi demonët zgjohen në perëndim dhe kanë ndikim më të madh te njerëzit, edhe tek të zgjedhurit si puna Ime. Keni vënë re se si krimet dhe mëkatet kanë nevojë për errësirën që të lulëzojnë? Kurvëria do errësirë, vjedhja do errësirë, vrasja po ashtu. Edhe mashtrimi do errësirë, ndoshta jo atë klasiken, pra mungesën e dritës, por atë të mendjes. Ajo zgjon demonët, dhe të gjithë ata ishin mbledhur në kokën Time dhe më flisnin.

V

Mëngjesin e ditës tjetër isha i kthjellët. Ky është një fillim normal dite, pas një nate pa gjumë. Në fakt atë natë ndjeva praninë e dikujt në shtëpinë Time. Në errësirë, herë pas herë dëgjoja të kërcitura që disa i shpjegojnë se, me rënien e temperaturës, sendet tkurren duke çliruar zhurma në shtëpi. Nuk e di. Ajo që di është se dritat i hapja sa herë ndodhte diçka e tillë. Dhe u bënë aq të shpeshta sa, gati-gati u kthyen në një shfaqje të shëmtuar dritëhijesh.

Isha disi më i qetë në mëngjes, krahasuar me natën, kuptohet. Madje mund të them se isha i ngazëllyer, sikur kisha hequr një peshë të rëndë nga kurrizi.

Mora dorëshkrimin dhe e lexova nga aty ku e lashë. Nuk kisha shpresa që ai do të përmirësohej. Goditja e parë, në çdo gjë, është vendimtare tek Unë. Nëse në çastet e para nuk më pëlqen, ashtu do të mbesë ajo. Por nuk po e lexoja që të më pëlqente, po e lexoja që të merrja ndonjë informacion shtesë mbi atë që e kish shkruar, dhe, gjithashtu, ta dija për çfarë fliste. Faktet duhet të njihen mirë fillimisht, që të manipulohen e të ndryshohen më pas.

Siç parashikova dorëshkrimi prej tridhjetë e gjashtë faqesh ishte mizerabël. Vërtet që Unë kam prirjen të shoh anët negative të gjërave, dhe këtë e di, por kush dreqin mund të shkruajë në letër që qielli është i kaltër teksa, e vetmja gjë që më duhet të bëj, është të ngre shikimin lart e ta shoh qiellin?

Vendosa ta ndryshoja atë dorëshkrim sa më parë, por duke mos prekur thelbin, pasi, duke e bërë këtë, personi që ma kish lënë në shtëpi, pasi ta shihte të botuar, të ndërgjegjësohej. Më tej do të reagonte që Unë e kisha ndryshuar dhe përvetësuar dhe do të dilte në shesh se kush ishte, më në fund.

Pasi të ndodhte kjo, lindi një pikëpyetje tjetër: ja doli personi, çfarë do të bëja Unë më pas? Cila do të ishte lëvizja e radhës?

E largova këtë mendim, duke ia lënë errësirës të së ardhmes.

Ç'është e vërteta, nuk kisha asnjë ide se si mund të shkruhej një vepër që të konsiderohej e mirë ose, të paktën, e pranueshme. Hapa internetin që të më ndihmonte. Lënda e parë ishte, por më mungonin aftësitë që ta gdhendja e t'i mbuloja defektet.

Interneti më shumë më ngatërroi se sa më kthjelloi mendimet. Pothuajse gjithandej thuheshin marrëzira të tilla si: autori nuk duhet të tregojë, por ai duhet të shfaqë. Shmangni sa më shumë ndajfoljet dhe mbiemrat dhe përqendrohuni tek emrat dhe foljet. Autori duhet të jetë i kujdesshëm që të mos gjykojë

në mënyrë të drejtpërdrejtë ngjarjet apo personazhet në tekst. Mos shkruani në ligjëratë të zhdrejtë, etj.

Rregullat konvencionale më ngjallin krupën. Po largohesha nga ajo që shkruhej në dorëshkrim sepse ecte sipas disa gjërave që lexuesit dëshironin të lexonin, për çfarë? Për të kaluar në disa rregulla të tjera që disa njerëz kanë vendosur.

Kuptova që ishte një marrëzi dhe mbylla faqen e internetit që gjoja duhej të më mësonte se si të shkruaja. Kuptova që ishte diçka personale që duhej t'ia dilja mbanë vetë.

Po, me fjalë. Ndërsa, kur ndodhesha përpara me faqen e bardhë, ajo ashtu mbetej me orë.

Kushdo qoftë ai që e kish shkruar atë dorëshkrim, kishte diçka, sado sipërfaqësore. Në kokë më gumëzhinin një mijë mendime, por isha i paaftë t'i hidhja në letër. Dhe përfytyroni që materialin e kisha, dhe më duhej thjesht ta modifikoja. E vetmja gjë që duhej të bëja ishte të zëvendësoja idealizmat e kota me një skepticizëm disi më kritik. Edhe tani që po shkruaj habitem për paaftësinë Time lidhur me atë gjë.

Më dukej vetja si një idiot, duke qëndruar para një faqeje të bardhë për orë të tëra. Por gjë tjetër nuk kisha çfarë të bëja. Nuk më priste ndokush atje jashtë dhe punë nuk kisha. Duke qëndruar vetëm para asaj faqes së bardhë, mendimet m'u shumëfishuan, dhe, nga pak po merrnin ngadalë formën e zërave.

Kuptova që nuk ishte çasti i volitshëm për të bërë diçka të tillë.

Nxora kartëvizitën e agjencisë funerale dhe i telefonova.

VI

Sapo m'u përgjigjën, Unë menjëherë nxora emrin e babait. I thashë që ishte ai që më rekomandoi tek ata. Zëri nga ana tjetër m'u duk miqësor. Më miqësor se në fillim domethënë. Më udhëzuan që të paraqitesha tek zyrat e tyre në nëntë të mëngjesit të ditës së nesërme. I thashë nëse kishte mundësi që të vija menjëherë tek ata, që të mos prisja gjithë atë kohë, por përgjigjja ishte negative.

Në të vërtetë kisha frikë t'i rikthehesha punës së dorëshkrimit, he për he. Dhe e keqja ishte se nuk kisha çfarë të bëja tjetër ndërkohë. Siç thashë, atje jashtë nuk kisha askënd, përveç babait, por ai, sigurisht që nuk do të ishte në dispozicionin Tim gjithë kohës. Televizori kishte muaj që nuk ishte ndezur në shtëpi dhe interneti po më kthehej në një lugat që më dilte edhe në ëndrra. Nuk ndjehesha i lirë kur ai më dilte para syve. Akoma më keq, ndjehesha i kontrolluar, i vëzhguar. Emrin në rrjete sociale dhe të postës elektronike e kisha me pseudonime, por prapë nuk mjaftonte. Që të sqarohemi, rrjetet sociale i përdorja për të parë të tjerët se çfarë bënin, ku ishin,

çfarë mendonin për botën. Më ngjallnin krupën ato punonjëse tek Institucioni ku punoja që hiqeshin si të ndershme dhe të papërlyera. Qëndroja me net të tëra pa gjumë duke gjurmuar fotografitë që nxirrnin diskot dhe pubet e qytetit, nëpër rrjete sociale, me bindjen se tek ndonjëra prej tyre, në ndonjë cep, ishin dhe ato. Duhet të kem kaluar me mijëra foto, derisa i kam kapur në prehrin e dikujt tjetër.

Nuk ia shfaqja asnjëherë. Mbaja për brenda vrerin e atij që ndjehej i mashtruar dhe i tradhtuar bashkë. Tradhtuar për çfarë? Do të thoshit ju. I tradhtuar nga ajo pjesë e shoqërisë që nuk më tregonte të vërtetën që Unë kisha për obligim të dija.

Të nesërmen u paraqita tek zyrat e agjencisë funerale me taksi, që të isha me i përpiktë në kohë. Lexova emrin e kompanisë. Shkruhej “Agjencia funerale 2K” me të verdha, në një sfond jeshil. Qëndrova disa çaste duke e studiuar dhe, sidomos, duke munduar të kuptoja se përse nuk ishte e shkruar në një sfond të zi, por i dhashë përgjigje vetes se e verdha dhe jeshilja ishin më parajsore si ngjyra. Ishte një strategji marketingu shumë e mirë, sepse e zeza është më dekurajuese, sidomos në shoqërinë shqiptare ku oguret janë gjithnjë në plan të parë. Suksesi, është edhe i lidhur me daljen nga klisheja. I dhashë pikë plus agjencisë për këtë gjë.

Shkova tek zyrat e pritjes dhe i thashë se kush isha. Në anën tjetër të tavolinës ndodhej një vajzë diku tek një metër e pesëdhjetepesë e gjatë, me

tipare të çrregullta të fytyrës. Kur them të çrregullta, asimetrike dhe joproporcionale siç kam thënë më sipër kur kam përcaktuar kriteret e Mia për bukurinë femërore. Mendova gjithashtu se me dikë të tillë nuk do të shkoja kurrë në shtrat, edhe sikur të isha Unë klienti i kompanisë ku do të punoja së shpejti.

Në rast se jeni kureshtarë të dini lidhur me jetën Time seksuale, dhe kjo është një pyetje retorike, sepse nuk ekziston njeri në këtë botë të vogël që nuk dëshiron të dijë sadopak lidhur me jetën seksuale të një individi; po ju them se është një përvojë që nuk kam provuar ndonjëherë. Mund të më konsideroni fanatik fetar ose një dështak, mua aq më bën. E vërteta është se këndvështrimet e mia ndaj seksit ndryshojnë nga hera në herë. Ndonjëherë më duket si një veprimtari kafshërore dhe, e parë nga syri i një të treti, thellësisht groteske. Dua të them, shihni pak dy qen duke u çiftuar në rrugë. Shihni pak mimikat, lëvizjet dhe, nëse afroheni mjaftueshëm, erën. Ka gjë më të neveritshme se ajo pamje? Thjesht të shihni fytyrat e njerëzve në çastet e orgazmës dhe ejakulimit dhe do të kuptoni se çfarë dua të them.

Herë të tjera, më duket si një lloj Olimpi i rezervuar për dikë që të më pëlqejë vërtet, por kjo nuk ka ndodhur, sepse ato që i konsideroj të bukura sipas standardeve të Mia, më rrisin pasiguritë. Pasiguri që në vetvete janë të konsiderueshme edhe në normalitet, jo më kur ndodhem para një perrie.

Ajo më kërkoi disa të dhëna të përgjithshme si dhe patentën e klasit B. Nga volumi i kërkesave, kuptova që nuk ishte shumë e ndërlikuar si punë dhe, sigurisht, do të paguhesha sa të mbaja frymën gjallë si pasojë. Në fund më sqaroi se isha i detyruar të vishesha me kostum serioz përgjatë gjithë orarit. Kostumin do ma siguronte agjencia dhe ishte standard për gjithë.

Firmosa kontratën. Në fund më tha që do të paraqitesha të nesërmen në orën tetë.

Kur dola, u drejtova tek një farmaci sepse pagjumësia po më bëhej e padurueshme. Jo në kuptimin se më shqetësonte fizikisht apo mendërisht, por më detyronte të jetoja më shumë në këtë botë. Edhe një botë e pakuptimtë si ajo e ëndrrave është më e mirë se tetë orarëshi i punës pjesën e parë të ditës, dhe ajo faqe përbindshmërisht e bardhë, pjesën tjetër. Gjëja që më pëlqen më shumë tek gjumi është pikërisht kjo: shkëputja.

Në farmaci kërkova një ilaç për gjumin, por përgjigjja e vetme ishte se nuk mundeshin të më jepnin ilaçe të tilla pa recetë. Që të merrja recetë duhej të vizitohesha, gjë që ishte e pamundur pasi nuk kisha për çfarë ta bëja një veprim të tillë. Si mundeshin që edhe për një biletë për në botën e ëndrrave, të më kërkonin të merrja lejen e një mjeku?

Këtë herë ia kurseva përgjigjen që farmacistja meritonte, atë “Shkofsh në drej” që i thashë nëpunëses së bankës që nuk më lejoi të shihja kamerat

vëzhguese. Thjesht i ktheva shpinën. Kur hapa derën, ajo më tha se do të bëja mirë të mbaja çamçakëz ditën, nëse vërtet nuk do merrja recetë për ilaçin e gjumit.

- Përse? - e pyeta.

- Lëvizja e muskujve të fytyrës do të të mbajë zgjuar.

VII

Atë ditë nuk dola më nga shtëpia. Brenda nuk kisha se çfarë të bëja, por edhe jashtë situata nuk do të ndryshonte. Mendimet se kush mund të ma kish vendosur atë dorëshkrim brenda në shtëpi, vinin duke u venitur gjithnjë e më shumë, duke ia lënë vendin qindra mendimeve të tjera që lidheshin me mundësitë se si ai dorëshkrim duhej të ndryshohej, por jo aq sa të humbiste tërësisht thelbin, sepse, siç përmenda më sipër, duhej ta nxirrte nga strofulli atë të mallkuar që ma kish vendosur.

Më dukej sikur çdo minutë që kalonte, ishte më e gjatë se tjetra.

Frika ime për atë dorëshkrim lidhej me faktin se, sapo ndodhesha para faqes së bardhë, asaj që Unë do shkruaja, do të ndodhte një lloj skizme në identitetin Tim. Ose, për të qenë më të saktë, do të krijohej një dyzim Imi. Keni parasysh ato filma vizatimorë ku heronjtë bënin punë të rëndomta ditën dhe, natën, vishnin kostumet dhe maskat dhe jetonin një jetë tjetër? Pikërisht ashtu ndihesha.

Frika qëndronte se kjo pjesë tjetër Imja, që do punonte natën, mund të më dilte jashtë kontrollit, dhe të përfshinte anën Time të rëndomtë. Nëse ndodhte kjo, rreziku ishte tepër i madh që veprimet dhe fjalët e Mia me ata pak njerëz që do takoja ditën, do të ishin jashtë kontekstit, pa vend. Duke ngjallur kështu dyshime. Nuk dëshiroja assesi që ndokush të dinte për planin Tim, derisa ai të dilte në pah.

Ndjeja që mendimet po më dilnin jashtë kontrollit. Ata sikur mundoheshin të hapnin kutinë e Pandorës të së ardhmes. Diçka që Unë enkas e lashë në errësirë të plotë. Por duhet theksuar që, nëse nuk merrem me diçka, ndryshe nga njerëzit e tjerë të cilëve mendja u punon tek e shkuara, duke liruar nga prangat demonët e saj, Mua mendja më punon tek e ardhmja. Kjo për shkak se ka atë sharmin e abstraktes, të paqenësishmes, pakufishmërinë e kombinimeve të mundshme të ardhura si pasojë e zgjedhjes.

Shumica e njerëzve janë të dështuar, sepse në çastet kritike të jetëve të tyre të tmerrshme bien në grackat e kujtimeve. Dhe ato janë si guralecë që, nëse hidhen, krijojnë ortekë që shkatërrojnë gjithçka.

Kështu edhe e fillova ripunimin e dorëshkrimit. Mora kujtimin e fundit të luftës dhe e vendosa të parin.

Ushtari në shtrat, që nuk kishte se çfarë të thoshte më asgjë, përveç rënkimeve, befas kthehej në zërin

rrëfyes që do të rikthehej me retrospektivë në tregimin e çdo gjëje që i kishin parë sytë. Në këtë formë do ta kisha më të kollajshme të hidhja në letër procesin ndryshues të luftës sepse, dihet, qeniet njerëzore i nënshtrohen rregullit të gjithëpranuar të ndryshimit.

Këtë e kisha të qartë në kokë, por vështirësia Ime e madhe qëndronte në hedhjen e saj në letër. Më dukej vetja si një sportist që e dinte me saktësi ku duhej ta dërgonte topin, por trupi nuk i përgjigjej mendjes dhe topi shkonte kuturu. Kështu më shkonin edhe fjalët.

Më pëlqeu ideja e një refleksioni që në faqen e parë. Dua të them, në cilindo grupim që të futen njerëzit, që në fakt janë dy, ata që besojnë tek rastësia dhe evolucioni, dhe të tjerët që besojnë tek një qëllim i epërm i ekzistencës dhe feja, bien dakord në një pikë: që në zanafillë të ekzistencës së njeriut ka qenë konflikti.

Përfytyroni në agimin e kohërave, një grup austrolopitekësh pranë një pellgu me ujë. Befas shfaqet një grup tjetër i cili, edhe ai do të shfrytëzojë të njëjtin pellg me ujë, për të pirë. Midis këtyre grupeve, që ende nuk kishin zhvilluar gjuhën dhe komunikimin, nuk mund të mos shfaqej konflikti. I pari që përdori gurin për të vrarë anëtarin kundërshtar, ishte ai që do të mbijetonte. Përdorimi i parë i mjetit bëri që të kalonte në fazën tjetër të zinxhirit, në atë të njeriut. Kalimin nga austrolopitek në njeri, e bëri përdorimi i mjetit të parë, dhe ky mjet u përdor për të vrarë. Ky

mjet u përdor, gjithashtu për të vrarë kafshët, duke zgjeruar dietën edhe më mish, që nuk do bënte gjë tjetër veçse të rriste agresivitetin e njeriut.

Nëse kalojmë tek feja, do të shohim gjithashtu se, që në fillim, historia nis me një vrasje, ose më saktë me një vëllavrasje, sepse të tjerë nuk kishte që të konsiderohej luftë, kjo nuk është gjë tjetër veçse një preambul për të përgatitur lexuesin e Shkrimeve të shenjta se çfarë rrjedhe do të merrte historia njerëzore.

Personin në fjalë vendosa ta lija pa emër, një ushtar të panjohur. Jo vetëm se me këtë mënyrë do të ishte kushdo, por edhe më dukej diçka banale pajisja e tij me një emër. Shto pastaj faktin se në luftë, për hir të së vërtetës, emrat janë të papërfillshëm. Njerëzit, në më të mirën e rasteve mund të emërtohen me kode apo numra.

Ndjeja që pas përshkrimit të gjendjes së tij përfundimtare dhe refleksionit, sikur po më zgjerohej nga pak hapësira e asaj që do të shkruaja. Sikur e kisha pak më të qartë se si do të vazhdonte më tej, ndihmuar edhe nga gjërat që shkruheshin në atë dorëshkrim.

Thënë kjo, vendosa ta lija për të nesërmen punën.

VIII

Gjatë gjithë rrugës për tek agjencia funerale mendja po më punonte tek vazhdimi i mundshëm i historisë. Jo vetëm kaq, por përshkrimet që më vërtiteshin në kokë po më bëheshin gjithnjë e më shumë të gjalla. Duke marrë parasysh tematikën e shkrimit, natyrshëm dilemat ekzistenciale po më fuqizoheshin më tej.

Në punë gjëja më e pakëndshme, pas atij kostumi tmerrësisht të parehatshëm, ishte pritja. Rrija për orë të tëra pa bërë gjë, aty, derisa na vinte lajmi për varrimin e radhës. Kaq.

Në kat të parë ishte aparati i kafes dhe aty mblidheshim dhe flisnim. Ditën e parë u prezantova me punonjësit. Fillimisht i hodha një sy përciptas njërit, por më pas e pashë më me vëmendje. Në vend të dorës së djathtë mbante një protezë. Ishte riprodhim shumë i mirë i gjymtyrës së humbur, për nga forma dhe ngjyra. Aq sa, po ta shihje në rrugë nuk do ta vije re. Nuk po ia shkisja sytë protezës. Menjëherë më lindi në kokë ideja se do të ishte e shkëlqyer që ushtarit të dergjur në shtrat, t'i mungonte edhe një gjymtyrë. Do t'i rriste akoma më shumë dramaticitetin.

- Çfarë ka, - pyeti ai, pasi unë nuk po i largoja sytë nga proteza.

- Dorën, - i thashë unë.

- Nuk e kam, - tha ai.

- Këtë e kuptova, gjithsesi kanë bërë një punë të mirë me protezën.

- Po, e kanë bërë në Itali.

- Ku e ke humbur?

- Në punë, - tha ai, - tek puna e mëparshme domethënë.

- Çfarë pune bëje atje?

- Tornitor. Një ditë të bukur më kapi freza dorën, ndonjë pyetje tjetër?

- Kam dëgjuar se kur humb një gjymtyrë vazhdon e ndjen sikur e ke ende, për shumë kohë.

- Broçkulla!

Tashmë ishte e qartë se fizionomia e punonjësit pa dorë do të ishte edhe ajo e ushtarit tek historia që po shkruaja. E kisha vendosur. Kisha nevojë të kisha një ide të qartë fizike të atij që do ta vija në qendër të historisë, pavarësisht se nuk do ta përshkruaja kurrë.

Që ta them troç, kam qenë një bylmez në histori. Për luftën në Kosovë nuk dija asgjë dhe vazhdoj të mos të di, edhe në këto çaste që po shkruaj. Gjithçka dija ishte ajo që ishte shkruar aty, por prapë, konteksti historik ishte shumë i vagullt, dhe i mbytur me qëllimet fisnike dhe patriotike të atij që kishte bërë dorëshkrimin. I vetmi fakt historik që përmendej,

ishite marrja në kontroll e Rahovecit dhe, kryesorja, shembja e manastirit të Zoçishtes i cili mbante eshtrat e Shën Damianit dhe Shën Kozmait, të konsideruara të shenjta edhe nga banorët vendas kosovarë. Ngjarja që tragjike, murgjit serbë u arrestuan dhe u dërguan në një shkollë të braktisur. Kjo xhindosi tërësisht palën serbe dhe kundërofensivat qenë të pashmangshme. Për të mos folur pastaj për popullatën e fshatit, të përbërë edhe nga serbë, fatet e shumë prej tyre u shënuan në atë ditë nga kosovarët, dhe gratë pastaj...

Dikush më thirri.

- Po, - iu përgjigja

Më dha vendin dhe orën që duhet të paraqitesha të nesërmen. Kishte një varrim.

- Në rregull, - thashë.

- Edhe një gjë tjetër.

- Çfarë?

- Hiqe atë çamçakëz kur je në xhenaze.

- Pse?

- Është mungesë respekti, si mendon?

- Në rregull.

Në fakt nuk kisha përse ta bëja një gjë të tillë. Çamçakëzi po funksiononte për mrekulli dhe nuk e çoja ndër mend ta hidhja. Do të ishte mungesë respekti sikur të më zinte gjumi në punë, ajo po. Por çamçakëzi? Edhe fundja, atë e kisha në gojë, askush nuk mund ta shihte. Unë, prapa syzeve të errëta kontrolloja gjindjen dhe, në çastin që vëreja që nuk po

më shihte askush, e kafshoja fort, më pas përtypesha. Muskujt tendoseshin dhe unë ndjehesha gjallë.

Do të ishte e kotë të thosha që ne nuk është se i kemi mirë marrëdhëniet me vdekjen. Kujat, ulërimat, piskamat më shkatërronin nervat gjatë gjithë rrugës nga shtëpia deri te varrezat. E kenë parasysh vetë sa ngadalë ecin parakalimet mortore. Dëshira ime ishte që të mbërrija sa më shpejt në varreza, të kryheshin ritualet, të thuhej fjalimi i fundit, të mbulohej me dhe' arkivoli, të shtrëngonin duart me familjarët, pastaj të lanin duart dhe secili të shkonte në punë të vet. Mundësisht brenda një ore, në mënyrë që të kthehesha tek agjencia e të mendoja për gjëra shumë më serioze, si për shembull ushtari në shtrat.

Tmerri vetë ishte kur shkonim në krahina për varrime. Në disa vende, mbanin çadra ku mblidheshin në grup dhe vajtonin. Kishte edhe gra që paguheshin për të vajtuar, në mënyrë që të përcillnin akoma më shumë vrerin e humbjes. Edhe kuja ka artin e vet dhe jo të gjithë mund ta bëjnë siç duhet.

Çamçakëzi në gojë, nga përdorimi, më kthehej në një gomë si ato që fshinin shenjat e lapsave fëmijët në kopsht. Nxora shaminë dhe e vendosa para gojës, më pas me stil e pështyva aty brenda dhe e bëra shuk dhe e vendosa në xhep. Pas disa minutash, pa rënë në sy e zëvendësova me një tjetër.

IX

Që ushtari të shkonte në luftë duhej një motiv. Ai i dorëshkrimit, pra dashuria për këtë tokë, më dukej shumë banal. Sa i sinqertë ishte vallë ai person kur shkroi ato gjëra? Përgjigja e kësaj pyetjeje ndodhet në fillimin e këtij shkrimi, kur paraqita gjënë e vetme që më pëlqen tek të sinqertët, pra aftësinë e tyre për të më bërë të qesh. Besomëni, e qeshura ishte vite dritë larg Meje kur isha para atyre fletëve të verdha. Më shumë ndjehesha i fyer, ose më saktë, intelekti Im ndjehej i tillë.

Kështu radhita disa mundësi më të qenësishme që mund ta shtynin atë individ drejt një realiteti të egër si ai i luftës.

E para ishte mundësia e një përfytyrimi të gabuar se çfarë ndodh realisht aty. Dikush që vetëm ka lexuar për luftën, apo maksimumi ka parë ndonjë film, sigurisht që e ka të vështirë të krijojë një fotografi të vërtetë të pamjeve reale të gjërave që ndodhin aty. Kështu motivi i parë mund të ishte për aventurë.

E dyta ishte mundësia e lavdisë personale dhe marrja e përvojave të tilla në mënyrë që të hidheshin

në letër, kështu që të krijohej një dëshmi për bëmat e një aspiranti hero.

E treta ishte interesi. Pra personi në fjalë vërtet po kontribuonte në lirim të vendit, por më pas, nëse do ishte me fat që t'ia dilte mbanë gjallë, do t'i lindte e drejta që të kërkonte, pse jo, të fitonte pozita drejtuese në pushtet.

E katërta, është ajo dëshira që fshihet në skutat më të thella të çdo njeriu. Dëshira që mbahet e burgosur nga zinxhirët e moralit dhe ligjit, por që del në pah kur këto dy rregullatorë të shoqërisë njerëzore, befas zhduken. Dëshira për të vrarë dikë, pa çarë kryet për brejtje ndërgjegjeje apo për pasoja penale.

Tundimi i madh ishte që të vendosja disa nga arsyet e sipërpërmendura njëkohësisht por më dukej se do të ishte jo shumë i besueshëm si personazh. Një ide më e mirë do të ishte nisja me një motiv të caktuar, si dëshira për aventurë, më pas gjatë rrugës ai do të ndryshonte. Llogarita mundësitë me gjakftohtësi dhe në fund mendova që kjo do të ishte zgjedhja e duhur. Njeriu ndryshon. Fundja siç e ceka më sipër, arsyeja se përse do e nisja nga fundi ishte pikërisht kjo gjë: tregimi i efektit ndryshues të luftës.

Motivi fillestar i aventurës përcaktoi vetvetiu edhe moshën e re të personit. Ky ishte i vetmi përshkrim që kishte të bënte me individin, bashkë me mungesën e dorës, sigurisht.

Dora po më lirohej dita ditës dhe ngjarjet filluan të rridhnin. Mësova vetë edhe sekretin se në çastin kur e kisha të qartë në kokë si do të vazhdonte, e ndërprisja, në mënyrë që mos të bllokohesha të nesërmen. Por bllokimi herët a vonë, do të më shfaqej.

Pas shumë kohësh, më në fund qëlloi një varrim i ritit ortodoks. U gëzova shumë nga kjo gjë. Dituritë e mia për jetesën e murgjve ortodoksë ishin afër zeros, dhe më duhej dikush që të më ndihmonte të më jepte të dhëna mbi to, që të përshkruaja murgjit e rrëmbyer nga kosovarët në Zoçishtë.

Ishte dita ime me fat, sepse shumica e njerëzve ose varroseshin në mënyra laike ose me rit mysliman. Shumë pak ishin rastet e katolikëve apo ortodoksëve.

Në mbarim të varrimit iu afrova priftit dhe i thashë në mund ta përcillja në kishë. Ishte një kërkesë e pazakontë, sigurisht. Ai më pa me habi, por në fund tha:

- Më çoj në shtëpi më mirë.

Hyri në makinë. Ishte goxha i gjatë dhe duhej të hiqte kapelën që mos të prekte tavanin. Mjekra gri i prekte gjoksin, ku varej një kryq i madh metalik me dekore. Rrinte i heshtur duke parë nga dritarja gjysmë e hapur. Unë po studioja mundësitë se si mund ta çoja fjalën tek jetesa e murgjve, pa hyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë ne temë. Diçka e tillë, së pari do të ishte diçka e çuditshme, se dyti, dhe më e rëndësishmja, do

të bënte priftin të pyeste veten për arsyen e pazakontë të kësaj pyetjeje, duke ngjallur dyshim.

- Ç'mendoni për luftën në Ukrainë? - pyeta befas.

Prifti shkëputi shikimin nga dritarja dhe lëvizi kryet ngadalë drejt meje. Kishte një vështrim pyetës.

- Nuk e di, - tha ai, - nuk u besoj shumë lajmeve që jepen në televizor.

- Lufta është e pashmangshme, - i thashë Unë, - nuk do largohet ndonjëherë. E di që ju jeni kundër por...

- Unë kundër? - ma ktheu dhe nënqeshi. - Gjysma e parë e Biblës flet kryesisht për të.

- Ah vërtet? - thashë Unë, - nuk e dija. Nuk e kam lexuar ndonjëherë.

- Më mirë mos e bëj, - ma preu ai.

Unë u kollita. Frenova gozhdë pa ndonjë arsye. Trupi i priftit shkoi pak para, por nuk shprehi ndonjë habi. Sikur e priste të ndodhte diçka e tillë. Gjithë ato mendime lidhur me jetesën e murgjve m'u rrënuan në çast si një kështjellë prej letre. Nëse do përshkruaja në formë pamore atë që kisha në kokë në ato çaste, do të ishte një shkarravinë. Nga ato shkarravinat e bëra me inat. Fillova të ndjeja atë fantazmën e bllokimit, pra pamundësinë për të shkruar diçka. Pikërisht atëherë që isha në kulmin e punës. U ndjeva tërësisht i pashpresë.

- Beson në Zot? - pyeti ai.

- Do t'iu tregoj një sekret.
 - Çfarë?
 - Unë jo thjesht besoj në Zot, por jam i zgjedhuri i Tij.
 - Lum si ti, - tha ai, - duhet të jetosh një jetë të mrekullueshme. Të jesh i zgjedhur nuk është pak.
 - Po, - i thashë Unë, - nuk është pak.
 - Mbaje këtu, - tha ai, - faleminderit.
- Pasi doli nga makina, vendosi kapelën në kokë dhe u largua ngadalë. Ectë drejt. Më dukej si një torrë e zezë që lëvizte në një fushë shahu të stërmadhe. Isha i bindur që nuk ishte shtëpia e tij aty.